

VENDIM
Nr. 127, datë 13.8.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK, ME NR. 246, SERIA FK14, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERES-s, NR. 102, DATË 21.12.2009, RINOVUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 84, DATË 16.9.2014

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”, nenit 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionet e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve, me nr. 67/15 prot, datë 16.7.2019; nr. 67/15-1 prot, datë 31.7.2019 dhe nr. 78/1 prot, datë 8.8.2019 lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k., me nr. 246, seria FK14, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 16.9.2014

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 119, datë 22.7.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës me nr. 246, seria FK14, të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 246, seria FK14 të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike që prej 21.12.2009, dhënë me vendim të bordit ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009 dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 84, datë 16.9.2014.

- Me shkresën nr. 32/33, datë 23.7.2019, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar ë nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GSA” sh.p.k.

- Në vijim të pyetjeve të ngritura nga bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 22.7.2019 në të cilën u relatua Relacioni me nr. 67/15, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, në datën 31.7.2019, u hartua Relacioni plotësues nr. 67/15-1 prot.

- Në këtë relacion plotësues u sqaruan pyetjet e ngritura në lidhje me datën e regjistrimit të shoqërisë që është ajo e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë, si dhe afati i vlefshmërisë së licencës që do të rinovohet, i cili fillon nga data 22.12.2019, duke qenë se licenca ekzistuese ka vlefshmëri deri në datën 21.12.2019.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE, nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Neni 16, pika 1, germa “a” – Formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, janë plotësuar.

- Neni 16, pika 1, germa “b” – Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, germa “a”/”b”; germa “c”; germa “d”; germa “e”, janë plotësuar.

- Neni 16 pika 1, germa “c” – Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, germa “a”; germa “b”, germa “c” germa “d”, janë plotësuar.

- Neni 16, pika 1, germa “d” – Çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike, është plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. me nr. 246, seria FK14, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 102, datë 21.12.2019, rinovuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE nr. 84, datë 16.9.2014, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 22.12.2019.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti